

Shefkije Islamaj

SHQIPJA STANDARDE PARA SFIDASH TË REJA

Viti 2008, viti i përvjetorëve të rëndësishëm të gjuhës shqipe, e gjen shqipen standarde para sfidash jo të vogla e jo të pakta.

Shqiptarët sot kanë kërkesa të tjera gjuhësore nga ato që kishte para 20 a 30 vjetësh dhe këto kërkesa ndryshojnë shpejt, sepse shqiptarët sot po kalojnë zhvillime të shpejta shoqërore, ekonomike e teknologjike. Në këtë kontekst ata kanë edhe ndjeshmëri të tjera. Shqipja standarde, prandaj, sot ka edhe sfida të tjera, sepse ajo u shërben shqiptarëve brenda e jashtë trojeve të veta dhe shqiptarëve që jetojnë në hapësira shumë të ndryshme shoqërore nëpër gjithë globin. Megjithatë, mbetet e rëndësishme së njëjtë nevoja për një gjuhë standarde të përbashkët për të gjithë shqiptarët kudo janë

Një sfidë të shqipes standarde e shoh sot në debatet që zhvillohen për vlefshmërinë e standardit të saj. Këtë debat e konsideroj anakronik, të rrezikshëm, por dështues. E shoh debat me prapavijë politike dhe të sponsoruar nga qarqe të ndryshme dhe për interesa të ndryshme. Dhe realizimin e një qëllimi politik, të deshifruar tashmë për ata që duan të kuptojnë, e shoh përmes paraqitjeve të individëve dhe grupeve të caktuara. Këta individë a grupe, për fat pakicë, por jo pak agresive në kohët e fundit, kërkojnë me çdo kusht të gjejnë përcaktues të rinj dallues midis shqiptarëve të Kosovës, shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të hapësirave të tjera shqiptare, përcaktues edhe gjuhësorë, përcaktues të tillë që do të krijojnë kufij të rinj psikologjikë midis tyre e që do t'i siguronin një identitet të ri një pjese të tyre, një identitet të paqenë a të panjohur për tërësinë së cilës i përkasin.

Procesi i ndarjes psikologjike brenda kombit ecën më së lehti duke shquar dallimet, duke shquar dallimet që realisht duhet të kuptohen të natyrshme e që lidhen me faktorë historikë e gjeografikë, socialë e kulturorë, duke shquar dallime më të vogla e më të parëndësishme, në të vërtetë duke shpifur dallime të paqena përmes ideologjizimit të këtyre dallimeve. Mbitheksimet e dallimeve midis toskëve dhe gegëve, midis toskërishtes e gegërishtes, midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës, midis gegëve brenda e jashtë Shqipërie po shfrytëzohen për pozicionime theksueshëm të ideologjizuara. Rreziku i një veprimi të këtillë qëndron pikërisht në faktin se një proces i këtillë i gjoja vetëdijesimit të gegëve për dallimet dhe “rrezikimin” a “humbjen” e identitetit gjuhësor, si edhe vetë

përpyjekja për krijimin e një etniteti të veçantë, të bartë me vete farën e vetëshkatërrimit. Nuk e di nëse janë të ndërgegjshëm këta individë e këto grupe për pasojat, sepse ndarjet gjuhësore janë baza e ndarjeve të tjera në jetën tonë kombëtare. Siç na e dëshmojnë shumë përvoja nga historia politike e botës, këto përpyjekje për ndarje gjuhësore lidhen në rend të parë me përpyekjen për krijimin e shpifur të një identiteti të ri.. Prandaj përpyjekja për ndarje kombëtare në fillim ka pikësynim një separatizëm brendagjuhësor e më pastaj brendakombëtar. Por, ajo që mund ta kenë harruar propaganduesit e ndasive është se këto përpyjekje për ndarje mund të ndodhin edhe në vetë korpusin nacional brenda për brenda grupit të imagjinuar homogjen, bie fjala brenda vetë shqiptarëve të Kosovës ose brenda vetë shqiptarëve të Shqipërisë. Këto dallime, fillimisht, s'është e thënë të jenë edhe ndarje politike, por ndarje të motivuara social-psikologjike, të cilat kurdoherë do të shprehen edhe në realitetin politik e shoqëror. Prandaj, pashmangshëm, do të na shtrohen pyetjet si këto: a do të jenë shqiptarët në gjendje t'i shohin e t'i deshifrojnë këto akrobaci linguistike të një grupi tash për tash të papërfillshëm e të pafuqishëm, apo do të ndodhë që ky "imponim" i ndasisë gjuhësore si kriter i jashtëm dhe si masë e identifikimit etnik, dikujt t'i krijojë edhe ndjenjën e pakicës brenda kombit të vet? Çka do të ndodhë nëse individë nga këto grupe fillojnë të këmbëngulin për dallime në variantet e tjera gjuhësore brenda korpusit të rikufizuar? A ka nevojë të thuhet se në këto raste pranimi ose mospranimi i veçantisë gjuhësore "të imponuar" më parë do të shërbejë si shenjë sugjerimi se në ç' masë ndihemi shqiptarë ose "kosovarë", apo sa jemi "kosovarizuar" në të vërtetë? A do të konsideroheshin, paskëtaj, këta "kosovarë" që do të pranonin ose nuk do të pranonin përcaktimin e ri të identitetit dhe të gjuhës, si tradhtarë të gjuhës e të kulturës së vet, apo sjellja e tyre gjuhësore do të kualifikohej si përçmuese e joluajale? Po cili është absurdi i këtyre përpyjekjeve? Për çudi këta individë dhe këto grupe na dalin propaganduesit më të mëdhenj për bashkimin me Evropën, për afrinë e ngjashmërinë historike e kulturore që kemi me Evropën, një synim ky edhe i çdo shqiptari, pa dyshim. Po si është e mundur që të jemi kaq të afërt, kaq të ngjashëm e kaq të dashur me Evropën e kaq të largët, kaq të ndryshëm e kaq armiqësorë mes vete? A do koment kjo?

Asnjëherë më shumë se sot nuk janë hedhur në ajër kaq shumë absurditet, të pavërteta, spekulime e injorancë lidhur me çështjen e gjuhës standarde. Injoranca shkon deri aty sa të quhen dialektet e shqipes gjuhë të veçanta, sa të trajtohet toskërishtja në raport me gegërishten si greqishtja në raport me shqipen, sa të quhet gegërishtja më e afërt me anglishten sesa me toskërishten. Jo vetëm kaq. Sipas asaj që na serviret nëpër palaço tv , palaço gazetë a palaço botime, del se një popull sado i vogël mund të ketë dy e sa të

dojë standarde gjuhësore, se kështu ndodhka edhe në Evropë (po, në Evropë, po në Evropën e fiseve e të shpatave e jo në Evropën e sotme). Apo ndoshta sipas multietnicitetit kaq të propaganduar sot te ne duhet të kemi edhe një multistandarditet gjuhësor; del se standardin duhet ta përcaktojë shumica e popullsisë (sikur të ishim në arenë për të matur fuqinë, numrin a peshën tonë); se gjuha e shkruar duhet t'i përshtatet gjuhës së folur, madje edhe zhargoneve; se normat drejtshkrimore duhet e mund të ndërrohen në çdo kthesë rruge apo sa herë nuk na pëlqen ose na zë rrugën ndonjë rregull; del se - trumbetojnë evropianizimin, ndërsa punojnë për anarkinë dhe konservativizmin. E kështu me radhë.

Këta individë propagandojnë edhe mbajtjen e një kongresi të ri për gjuhën standarde. Kërkojnë kongres jo për të përmirësuar standardin, po për ta rrënuar atë. Këta zëra, po kështu, kërkojnë të rishqyrtohet e gjithë historia jonë kulturore, në të vërtetë të “riedukohet” populli shqiptar duke ia harruar traditën ose një pjesë të madhe të saj, si në kohën e komunizmit, duke ia rishkruar e ndryshuar historinë thuajse ajo nuk ndodh po sajohet sipas dëshirave e interesave, duke ia krahinorizuar gjuhën, duke ia vulgarizuar jetën e duke i rivënë norma të reja “morale”. Shtrohen, prandaj pyetjet: sa kongrese u duhen shqiptarëve për të mbyllur një çështje e për të ecur përpara? Pse shqiptarët duhet të ndryshojnë e të rishkruajnë historinë siç kërkojnë individë, grupe, parti a qeveri? Pse për shqiptarët nuk vlejnë parimet që vlejnë për popuj të tjerë? Sa punë do të bënte një kongres për gjuhën për këta zëra dhe për sa kohë, sepse mund të dalin të tjerë më pas të kërkojnë sërish kongrese të reja? Duhet të bëhemi më serioz, sepse gjuha është çështje serioze, nuk është punë kafenesh, seancash spiritiste a shakash ndjellakeqe. Standard i shqipes është pranuar në kohë, në rrethana e në kushte të caktuara, ashtu siç janë pranuar më në fund edhe standardet për shumë gjuhë të tjera, një standard që përmbush mirë funksionet dhe nevojat gjuhësore për bartësit e saj, një standard që tashmë ka bërë një moshë, një moshë që nuk do të lejonte aventura linguistike e jolinguistike pa pasoja të rënda, një standard me probleme si çdo standard, një standard që duhet të zhvillohet e të pasurohet, një standard që duhet më tej të ndërtohet e jo të rrënohet.

Prandaj, sot del e rëndësishme të mbrohen vlerat tona kombëtare, pjesë e të cilave, më e rëndësishmja, është gjuha standarde shqipe, vlerat e krijuara me aq mund, në kushte e rrethana historike shumë jofavorizuese për ne. Dhe kjo do të duhej të ishte detyrë shkencore, intelektuale e morale e secilit prej nesh. Mbrojtje e gjuhës standarde do të thotë mbrojtje e qenësisë

sonë sidomos sot në kushtet e një qytetërimi kaq të përbërë, në kushtet e globalizimit, kur janë të rrezikuara sidomos gjuhët e kulturat e vogla. Sot edhe për popujt e mëdhenj miliardësh siç janë kinezët del shumë i rëndësishëm kohezioni kombëtar përmes një gjuhe të përbashkët. Pse duhet të jetë ndryshe për shqiptarët? Kinezët duke qenë pjesëtarë të shumë dialekteve e nëndialekteve dhe të një hapësire shumë të gjerë të gjeografisë fizike e të gjeografisë gjuhësore, merren vesh mes vete vetëm përmes gjuhës së shkruar standarde, gjuhës së përbashkët.

Prandaj, ai që ka dy kokrra mend duhet ta dijë rëndësinë e gjuhës së përbashkët standarde, edhe për ne, që kemi ecur dhunshëm të ndarë për kohë të gjatë. Gjuha e përbashkët standarde na ka bashkuar e po na bashkon në përmasën kryesore të qenësisë sonë. Dhe, ky bashkim sa vjen e shtohet sot dhe nesër do të jetë shumë më i madh pikërisht në saje të gjuhës së përbashkët. Të ndarë gjuhësisht do të ishim të ndarë edhe shpirtërisht, edhe fizikisht. Dikush e do ndarjen e tonë. Pavarësimin e Kosovës dikush e përjeton shans për ndarjen e shqiptarëve e jo shans për bashkimin, që do të ishte më se normale e më se e natyrshme në të ardhmen që do ta krijojmë të bashkuar.

Takimi ynë sot me temën “Shqipja standarde në Kosovë në vitin e përvjetorëve të mëdhenj” përçon mesazhin kudo ka shqiptarë se gjuha shqipe është pasuria jonë më e madhe. Prandaj ta duam, ta ruajmë e ta zhvillojmë, se ashtu e duam veten.

*Tryeza e Shoqatës së Gjuhës Shqipe, Prishtinë, 6.12.2009